

PROJEKT-PLATFORMË

Edhe pse pa u shprehur të gjithë anëtarët e grupit, po ju parashtroi së pari disa propozime që kanë të bëjnë me organizimin e veprimtarisë:

1. Për formatin e veprimtarisë janë shprehur, tashmë, tri mendime:
 - a. Kongres, i propozuar nga ju.
 - b. Kuvend i Studimeve Albanologjike (duke marrë si gjedhe Kuvendin e Studimeve Ilire të para 50 vjetëve)
 - c. Konferencë e Studimeve Albanologjike (mendimi mbizotërues, sepse ajo mbulon tërësisht çështjet që mendohet të trajtohen).
2. Nisur nga përmasat e veprimtarisë, pavarësisht projekt-platformave të paraqitura deri tani, duhet të ngrihet një Komision organizues ndërdisiplinar, i cili të hartojë një platformë me të gjitha elementet e nevojshme (motivimi, qëllimi / synimi, përmbajtja, formate rrugët e realizimit, koha etj.)
3. Komisioni organizues duhet ta fillojë punën nga konsultimet e drejtpërdrejta me grupet e interesit jashtë dhe brenda vendit.
4. Koha e mbajtjes së veprimtarisë të jetë nëntori i viti 2022, si vit që lidhet dhe me 50-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit.
5. Mqs propozohet një Komision ad hoc, unë po ju përcjell mendimet e kolegëve pa bërë ndryshime, si shtojcë e kësaj projekt-platforme.

Me respekt

Prof. dr. Valter MEMISHA

Kryetar i Komisionit të përhershëm të gjuhës dhe të Letërsisë

SHQIPËRIA DHE SHQIPTARËT NË SHEK. XXI

KUVEND NDËRKOMBËTAR MBI HISTORINË, GJUHËN DHE KULTURËN SHQIPTARE

(TIRANË NËNTOR 2021)

Gjuha shqipe ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të shumtë, sidomos nga shekulli XIX e këtej. Ndihezat e gjuhëtarëve, si Franz Bopp-i, Demetrio Camarda, Gustav Meyer-i, Holger Pedersen-i, Nobert Jokl-i, Marco La Piana, Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Selman Riza, Androkli Kostallari, Idriz Ajeti, Besim Bokshi, Eilfried Fiedler, Rexhep Ismajli, Jani Thomai, Jorgji Gjinar, Ethem Likaj, Seit Mansaku, Koleç Topalli, Gjovalin Shkurtaj, Bahri Beci, Xhevat Lloshi etj., kanë bërë të mundur që, duke kapërcyer vështirësi të shumta, të sqarohen pak a shumë fazat e hershme të historisë së saj, si dhe të arrihen rezultate të mira në studimin e dukurive dhe të strukturës fonemore, gramatikore e leksiko-semantike të saj.

Siç është dëshmuar tashmë përfundimisht, gjuha shqipe bën pjesë në familjen e gjuhëve indoevropiane, që përfshin gjuhë të gjalla dhe të vdekura, të cilat kanë afri e bashkëpërkime në sistemin fonetik, në strukturën gramatikore dhe në fjalorin e trashëguar. Ajo, ashtu si dhe gjuhët e tjera të kësaj familjeje, ka evoluar në mënyrë të shkallëshkallshme gjatë shekujve dhe, çka është kryesore, u ka qëndruar rrebesheve të kohës. Me gjithë trysnitë e forta dhe të gjata të greqishtes, të latinishtes, të sllavishtes dhe të turqishtes, ajo i ka ruajtur tiparet thelbësore.

Shekulli XX e gjeti shqipen me një status të ri. Në qoftë se periudha e Rilindjes Kombëtare u karakterizua nga përpjekje të shumta e të pareshtura për shkrimin e saj, shpallja e Pavarësisë e kthen atë në gjuhë zyrtare të shtetit të sapoformuar shqiptar. Zhvillimet e shumta që ndodhën në jetën e popullit tonë, që nga kjo ngjarje përcaktuese për ekzistencën e kombit shqiptar e deri më sot, janë shoqëruar me zhvillime të shumta dhe në vetë gjuhën tonë amtare. Ngjarja me madhe në historinë e saj moderne është Kongresi i Drejtshkrimit, nëntor 1972, si kurorëzimi i procesit mbil00-vjeçar për ta unifikuar e kodifikuar atë, për të krijuar variantin e saj të kombëtar të njësuar, që sot njihet si shqipja standarde.

Pas Luftës së Dytë Botërore, studimet për shqipen u institucionalizuan dhe u organizuan nga shteti; ajo që është më e rëndësishme, qendra e studimeve për të e për krejt studimet albanologjike u bë Tirana. Krijimi i Akademisë së Shkencave e ngritja e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në përbërje të saj, sollën më tej një hop cilësor në studimet gjuhësore dhe sidomos në hartimin e veprave fundamentale që lidhen me shqipen e sotme; u thelluan e u ngritën në një shkallë të paparë studimet historiko-gjuhësore dhe etimologjike, studimet fonetike e fonologjike, morfologjike e sintaksore, stilistikore e sociolinguistike; u mblodh një pasuri gjuhësore dialektore e madhe, që mundësoi e mundëson ndërmarrjen e studimeve të shumta e shumëdrejtimëshe etj.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksojmë se në viset e tjera shqiptare jashtë Shqipërisë, sidomos në Kosovë, lufta për shqipen e kulturën tonë kombëtare ka qenë e paepur dhe e papushuar për t'i shpëtuar ato nga asimilimi. Ngritja e Institutit

Albanologjik të Prishtinës në vitet '50 të shekullit të kaluar, e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si dhe e Universitetit të Prishtinës, u dhanë shtytje të jashtëzakonshme studimeve për shqipen. Ngjarjet që rrodhën pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe pas vendosjes së pluralizmit, sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kanë sjellë frymëmarrje të gjerë në të gjitha aspektet e punës kërkimore shkencore, në studimin e gjendjes së shqipes në rrafshin diakronik, diastratik, diatopik, si dhe në evidentimin e prirjeve të zhvillimit të saj. Prishtina u kthye pashmangshmërisht në qendrën e dytë të rëndësishme të studimeve tona.

Duhet nënvizuar që shekulli XXI solli frymë të re dhe intensifikim të bashkëpunimit e të integritimit më të mirë të studimeve dhe të kërkimit shkencor në gjuhësinë shqiptare. Janë me dhjetëra veprimtaritë shkencore mbarëkombëtare me prurje të rëndësishme në të gjitha fushat e studimit. Janë me dhjetëra studiuesit e rinj që u përgatitën në shkollën gjuhësore shqiptare e për gjuhësinë shqiptare.

Studimet për gjuhën shqipe kanë pasur rritje sasiore e cilësore të rëndësishme dhe në mjediset arbëreshe dhe arvanitase. Përmendim këtu studimet e Tito Johallasit, të Françesk Altimarit, të Mateo Mandalait, të Xhani Belushit etj.

Vërejmë, gjithashtu me kënaqësi se, krahas Tiranës e Prishtinës, tani edhe Shkupit, për asnjë çast nuk kanë ndalur studimet për shqipen nga studiuesit / albanologët e huaj. Po përmendim këtu studimet e albanologëve gjermanë, austriakë, italianë, amerikanë, rusë, bullgarë etj.

Tashmë ka ardhur koha të bëhet një bilanc i studimeve albanologjike si një fushë e gjerë ndërdisiplinore dhe të përvijohen perspektivat e studimit në një kuvend me përmasa ndërkombëtare.

SEKSIONET

Gjerësia e tematikës kushtëzon punimet në disa seksione

I. Çështje të diakronisë së gjuhës shqipe

- a. Tezat rreth origjinës së gjuhës shqipe
- b. Marrëdhëniet parahistorike të gjuhës shqipe me gjuhët e lashta
- c. Probleme të periodizimit të shqipes
- ç. Zhvillime historike të strukturës gramatikore të shqipes
- d. Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera në zhvillimin e saj historik
- dh. Ngulimet gjuhësore në Greqi, Itali, Bullgari, Ukrainë, Kroaci etj.
- e. Ngjarje që kanë përcaktuar rrugëtimin e shqipes në shekuj
 - Kuvendi i Arbënit
 - Kongreset gjuhësore për shqipen e arbërishten në shekullin XIX
 - Kongresi i Manastirit
 - Komisia Letrare e Shkodrës
- ë. Botimet filologjike të teksteve të vjetra shqipe - themel i domosdoshëm për studimin e historisë së gjuhës shqipe

II. Gjuha shqipe në rrafshin sinkronik

1. Gjuha shqipe dhe shqipja standarde, studimet për përmirësimin, shtrirjen e përsosjen e funksioneve:

- a. Organizimi dhe ngritja e strukturave studimore; bashkëpunimi
- b. Veprimtari të rëndësishme shkencore
 - Sesionet shkencore të vitit 1952
 - Konferencat shkencore albanologjike
 - Konsulta e Prishtinës

- Kongresi i Drejtshkrimit
- Konferencat kombëtare për leksikografinë, terminologjinë etj.
- Ekspeditat hulumtuese dialektologjike e leksikologjike në terren

2. Studime: Fusha, metoda e shkolla gjuhësore

- a. Dialektet e shqipes, - burim i pashteruar hulumtimi
- b. Studime sociolinguistike
- c. Studime etnolinguistike
- ç. Studime në fushën e fonetikës e të fonologjisë
- d. Studime në morfologji e fjalëformim
- dh. Studime për morfologjinë e eptimit
- e. Çështje të sintaksës së sotme
- ë. Studime në fushën e ligjërimit gjuhësor; arritje në studimin e stilistikës gjuhësore
- f. Studime në fushën e leksikologjisë e të semantikës leksikore
- g. Leksikografia historike, sinkronike, njëgjuhëshe, dygjuhëshe; vepra të pritshme
- gj. Terminologjia dhe sfidat e saj në epokën e globalizmit
- h. Studimet onomastike (etnonime, patronime, toponime)
- i. Sistemet teorike e shkollat gjuhësore në shërbim të albanologjisë
- j. Metodologjia e metoda në gjuhësinë shqiptare

III. Studime për letërsinë shqipe

- a. Rreth periodizimit të historisë së letërsisë shqiptare
- b. Dukuritë letrare shqiptare dhe dukuritë letrare evropiane: vonesat dhe asimetritë
- c. Letërsi shqipe apo letërsi shqiptare
- ç. Diasporat shqiptare dhe letërsia shqipe
- e. Qarqet letrare në fundshekullin XIX e në shekullin XX: kur u homogjenizua letërsia shqipe
- ë. Nën sistemet e letërsisë shqipe: shkaqet e fragmentarizimit
- f. Drejtime e rryma letrare avantgardë dhe të vonuara
- g. Autorë dhe vepra me njohje dhe vlerësim përtej kufirit të shqipes

IV. Studime antropologjike

- a. Etnonimi i shqiptarëve, arkeonimet, endonimet, ekzonimet: etnonimet dhe lingonimet
- b. Ndarja etnokrahinore e hapësirës historike shqiptare: kufijtë e krahinave dhe të dialekteve
- c. Totemitë, tabutë, eufemizmat antropogjuhësorë tek shqiptarët
- ç. Rituale zanafillëse dhe mite paganë tek shqiptarët: ritet e lindjes, martesës, vdekjes
- d. Tipologjia e veshjes tek shqiptarët, krahasuar me ndarjen etnokrahinore dhe dialektore
- dh. Dukuri arkaike të mbijetuara: merkoshi (couvade) etj.
- e. Kur lind dhe kur mbyllet eposi i shqiptarëve, kur nis epika historike e tyre
- ë. Lahuta, kulla, rendi në familje
- f. Ekzogamia dhe endogamia
- g. Kanunet, si albanizëm antropologjik.
- gj. Polifonia dhe homofonia, dy dukuri paralele me ndarjen dialektore dhe krahinore

Shënim. Zërat e shenjuar me të kuqe janë propozimet e shtuar nga akad. J. Thomai.

Shënime

Për veprimtarinë janë prononcuar disa anëtarë të Komisionit. Me qenë se tre prej tyre u shprehën më plotërisht, po ju nisim dhe mendimet e dhënë nga secili. Prononcimet e prof. Seit Mansaku dhe prof. Anila Omari janë të shkruara te Propozimet.

A. Jani Thomai (24.04.2020)

1. Një veprimtari e tillë është e kohës dhe e mundshme të organizohet me bashkëpunimin e të gjitha institucionet shkencore shqiptare të këtyre fushave.
2. Mendoj që veprimtaria të quhet “Konferencë ndërkombëtare për studimet albanologjike”, siç ka edhe paraardhëse të saj të suksesshme.
3. Vizioni i Konferencës të jetë përgjithësues, si për vlerësimin e arritjeve, ashtu edhe për orientimin e studimeve në të ardhmen. Kështu edhe tematika e saj në platformë duhet të orientojë drejt trajtesave përgjithësuese, jo thjesht si bilance arritjesh a përshkrime historike, por si studime problemore.
4. Konferenca t’i zhvillojë punimet në një seancë plenare dhe në 4 seksione (sipas fushave).
5. Paraprakisht kam bërë disa ndryshime e shtesa, sidomos në pjesën “II. Gjuha shqipe në rrafshin sinkronik” (të selektuara me të kuqe). Çështja e alfabetëve më duket e panevojshme.
6. Më duket i drejtë propozimi për ta zhvilluar këtë Konferencë në nëntor 2022, jo vetëm me rastin e 50-vjetorit të Kongresit të drejtshkrimit, por edhe për t’u përgatitur më mirë për të gjitha kërkesat e një konference të tillë kombëtare.
7. Këtë vit mund të zgjidhen çështjet organizative: Platforma përfundimtare, pas diskutimeve të këtij varianti; grupet e punës për organizimin e Konferencës e të seksioneve të saj; lista e të ftuarve për t’u përfshirë në programin e Konferencës me kumtesa dhe hartimi i një programi paraprak; procedurat për sigurimin e fondeve financiare etj.
8. Hyrja e Platformes është e gjate, me të dhëna historike-gjuhesore të njohura e të panevojshme dhe vetëm për gjuhën shqipe e gjuhesinë shqiptare. E kuptoj që kjo është bërë për diskutim në Komisionin e përhershëm të gjuhes e të letrarisë pranë ASH, por edhe kështu mungon hyrja për letrarisë. Nderkaq mendoj se duhet një hyrje e përgjithshme për të gjitha fushat, pra, të përfshijë edhe letrarisë, antropologjinë, historinë, kulturën (tematika për historinë mungon në Platforme; shih titullin).

Para se gjithash te jepet pse duhet te behet kjo konference, boshti qendror i saj, synimet, menyra e organizimit dhe e zhvillimit te punimeve, pjesemarrja etj. Nese do te kete nje hyrje te shkurter te vecante per gjuhen shqipe e gjuhesisne shqiptare, duhet te kete te tille per cdo fushe (letersi, histori...). Pra, vete Platforma ka nevoje per plotesime dhe organizim sistemor te brendshem.

B. Gjovalin Shkurtaj

Konferenca nderkombetare e vitit 2021

Te dashur kolege,

Do te kisha deshruar qe leximin dhe vleresimin e kesaj Platforme ta kishim bere se bashku, ne nje takim pune, si dikur, por ne kushtet e mbylljes nga covid-19 nuk e kemi me ate "luks".

Ne vijim, po edhe ne mbeshetjet te asaj qe ka shprehur prof. Anila ne keshillim dhe me prof.Seitin,po lejohem te shpreh edhe une sa vijon:

Ideimi dhe projekt-platforma e Konferences Nderkombetare...te 2020-es,sikunder shihet (dhe mirekuptohet) eshte hartuar me " kohe te mire", para se te mbylleshim ne shtepi nga covid-19. Dhe eshte nje platforme e gjere, e lakmueshme, por tadhme gjithsesi me e gjere sesa mundesite dhe pritshmerite qe kemi.

Pas kesaj situatë (po edhe ne kushtet e pritshme qe kurrsesi nuk kane per te qene me te atilla si me pare) mendoj se kjo platforme,si dhe krejt sa eshte planifikuar ne te, duhet me doemos te rishikohet, te marre kahe e permasa me modeste dhe,sidomos, me te percaktuara, mbase edhe dukshem me te perqendruara ne nje bosht te madh e te qarte, si p.sh."Shqipja e shkruar dhe e folur ne kushtet e lirise se shorehjes" (ad hoc).

Pra, pa asnje paragjykim, mund te marrim si gjedhe Konferencen e organizuar me 1992, kushtuar 20-vjetorit te KD-se.

Pra, mendoj qe, se pari, pergatitja e konferences te kete me shume kohe dhe pikerisht per kete te shtyhet per vitin 2022 dhe te behet me rastin e 50-vjetorit te Kongresit te Drejtshkrimit.

Per te pasur rezultatin e deshirushem, ritheksoj se duhet te kemi nje bosht e disa pikesynime te qarta trajtimi, si p.sh.cfare ka mbetur pa u bere plotesisht ose cfare nuk eshte bere mire deri sot, sipas fushave perkatese me kryesore: ne drejtshkrim, ne normativizimin gramatikor e leksikor, ne gjuhen e teksteve shkollore e ne perkthimet shkencore e profesionale, ne letersine artistike e ne perkthimet nga gjuhet e huaja etj.

Per jetesimin e nje platforme me disa pika me te sigurta e me te qarta, po edhe te mundshme, mbeshet idene e prof. Aniles e te prof.Seitit.

Por, ritheksoj se, me rastin e 50-vjetorit te Kongresit te Drejtshkrimit, qe bie ne nentor te 2022-se, eshte jo vetem rasti i duhur, por edhe domosdoshmeri per vleresimin dhe miratimin e nje pohimi te ri te rendesise shkencore e kombetare qe ka ajo ngjarje dhe Rezoluta e KD-se, tumirimi me ate rast i veprave qe jane botuar me frymen e atij kongresi, si Rregullat e Drejtshkrimit dhe Fjalori Drejtshkrimor i Gjuhes Shqipe. Nderkaq, deri ne daten e ditën e Konferences se 2022-se duhet te kete perfunduar kundrimi e vleresimi perfundimtar i punes se bere nga Keshilli Nderakademik i Gjuhes Shqipe, qysh nga krijimi i tij me 2004 e deri sot, duke mberitur patjeter edhe ne gatitjen per shtyp e miratimin ne Konference te ribotimit te Rregullave te Drejtshkrimit te Gjuhes Shqipe e te Fjalorit Drejtshkrimor.

Natyrisht, kur te mblidhemi(ne dashte Zoti te dalim nga ngujimi) do te kemi rastin te shtojme edhe elemente konkrete te lidhura me disiplinen gjuhesore te shtetit e te shoqerise shqiptare, duke theksuar (qofte edhe pse te perderitura) verejtjet e kritikate dashamiresore qe jane bere nga gjuhetaresit dhe dashamiresit e shqipes deri sot, por qe

nuk kane gjetur zbatim, per te mos thene: jane shperfillur gati masivisht. Si p.sh. Le t'i themi atyre, thoja per thosha, puna mbare ne vend te puna e mbare, si dhe "perlat" e pornologjierimeve ne mediat e folura etj.

Qofshi mire dhe dalshim shendosh e sa me pare nga kjo situuate.

C. Shezai Rrokaj

Mirdita kolegë!

Duke uruar çdo të mirë për secilin prej jush dhe familjet tuaja, po shpreh ndonjë mendim: Përgjithësisht, bie dakord me sugjerimet e disa kolegëve që i kanë shprehur në vijim të draftit të propozuar. Shumë shkurt edhe unë dua të ndaj me ju disa paqartësi: 1) Mungon qëllimi a synimi i kësaj veprimtarie: pra çfarë synohet, çfarë kërkojmë të arrijmë, sepse në funksion të synimit, mund të kemi një gjykim më të qartë për platformën 2) Termi Kuvend është emfatik. Përgjithësisht ky term, ashtu si dhe Kongres, nënkupton vendimmarrje të rëndësishme, gjë që nuk duket në këtë platformë. 3) Termi 'kombëtar' është gjithashtu problem. Nuk e di nëse ka pasur konsultime me strukturat akademike apo dhe studiues të veçantë në Kosovë si dhe në treva të tjera, Maqedoni, Kalabri, Greqi. Gjithashtu ky term, dashur pa dashur 'përjashton' studiues 'jokombëtarë' që merren me shqipen. 4) Meqenëse është fjala për albanologji, do ishte e kuptueshme një konsultë e seksioneve që përfshin kjo fushë. Si përfundim, nëse kjo veprimtari nënkupton thjesht dhe vetëm që studiuesit të sjellin kontribute të tyre për fushat përkatëse duhet gjetur një formulim, bie fjala, Konferencë e Studimeve Albanologjike 2020.

Por mendoj se do të kishte qenë më dobiprurëse të hapej një diskutim më i gjerë rreth disa ideve që janë hedhur në qarkullim, si: 1) Diskutime rreth draftit të Këshillit Ndërakademik, në të cilin janë evidentuar disa problematika për standardin; 2) A ka nevojë për një ligj për standardin (gjuhën shqipe)? 3) Nevoja e ndërtimit të një korpusi kombëtar, por edhe të korpuseve të veçanta që do të ndihmonin për një qasje më të matshme të gjuhës në përdorim, nga ku mund të projektohet një reformë e pritshme e standardit si dhe për të hartuar vepra madhore si Fjalori e Gramatika thesaurus etj.

Te fala të gjithëve!